



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 24 shtator 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 9, 95(2)(b) dhe 102(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara (“Rregullorja”), nxjerr këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 23 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndër të tjera, urdhëroi që Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) të dorëzonte një njoftim të hollësishëm të provave të rregullës 102(3) të Rregullores deri të premtën, 30 prill 2021.²
2. Më 24 mars 2021³ dhe 24 qershor 2021,⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake zgjati afatin e ZPS-së për dorëzimin e Njoftimit sipas Rregullës 102(3) (“Njoftimi”).
3. Më 31 korrik 2021, ZPS-ja dorëzoi Njoftimin.⁵
4. Më 8 dhe 14 shtator 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ndryshoi më tej afatet lidhur me nxjerrjen e materialit të rregullës 102(3) dhe përsëriti se ZPS-ja duhet të nxjerrë ose lejojë qasje në materialin e zgjedhur, ose të parashtojë kërkesë për masa mbrojtëse brenda tri javësh nga njoftimi/njoftimet e Mbrojtjes, si dhe të paraqesë kundërshtimet e veta në lidhje me rëndësinë materiale të materialeve të rregullës

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me Të*, (“Vendimi Kornizë”), 23 nëntor 2020, publik, para. 99(f).

³ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 24 mars 2021, publik, f. 390, rreshti 17 deri në f. 391, rreshti 10.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00370, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatje të Afatit për Dhënien e Njoftimit sipas Rregullës 102(3)*, 24 qershor 2020, publik; Transkript i seancës, 14 shtator 2021, publik, f. 625, rreshti 24 deri në f. 625 rreshtat 1-21.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00421, Prokurori i Specializuar, *Njoftimi i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3)*, 30 korrik 2021, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

102(3) të kërkuara nga Mbrojtja, brenda dhjetë ditësh nga njoftimi/njoftimet e Mbrojtjes.⁶

5. Më 23 shtator 2021, ZPS-ja kërkoi zgjatjen e afatit për paraqitjen e kundërshtimeve mbi rëndësinë materiale, si dhe të afateve përkatëse për nxjerrjen e materialit dhe/ose për masa mbrojtëse ("Kërkesa").⁷

II. PARASHTRIMET

6. ZPS-ja kërkon: (i) zgjatje njëjavore të afatit, përkatësisht deri më 1 tetor 2021, për paraqitjen e kundërshtimeve mbi rëndësinë materiale, nëse do të ketë; dhe (ii) zgjatje të ngjashme njëjavore të afatit përkatës për nxjerrjen e materialit dhe/ose parashtrimin e kërkesave për masa mbrojtëse.⁸ ZPS-ja parashtron se janë paraqitur arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit duke qenë se zgjatja e afatit ka të bëjë me nxjerrjen e 3466 materialeve të kërkuara nga Mbrojtja e Hashim Thaçit më 14 shtator 2021 ("Kërkesa e Thaçit për Materiale të Rregullës 102(3)") dhe do të ndihmojë diskutimet aktuale *inter partes* që kanë si synim shmangien e kontestimeve juridike të panevojshme në lidhje me nxjerrjen e këtij materiali.⁹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Në bazë të rregullës 9(5)(a) të Rregullores, nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, Paneli mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje apo prej Panelit.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00460, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshim të Njoftimit sipas 102(3)*, 8 shtator 2021, publik, para. 27.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00485, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit ("Kërkesa")*, 23 shtator 2021, publike.

⁸ Kërkesa, para. 2.

⁹ Kërkesa, para. 3.

8. Në pajtim me rregullën 9(6) të Rregullores, në qoftë se nuk i shkaktohet dëm palës kundërshtare, vendimi mbi një kërkesë për ndryshimin e afatit mund të merret pa i dhënë palës kundërshtare mundësinë për të shprehur mendimin.
9. Rregulla 95(2)(b) parasheh se Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcakton afatet për nxjerrjen e materialeve në përputhje me Kapitullin 7.
10. Rregulla 102(3) e Rregullores përcakton se, në përputhje me nenin 21(6) të Ligjit, Prokurori i Specializuar i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për çdo material dhe provë që ka në zotërim. Materiale të tilla nxirren pa vonesë. Prokurori i Specializuar i drejtohet menjëherë Panelit në qoftë se ekzistojnë arsye për kundërshtimin e rëndësisë materiale të informacionit.

IV. DISKUTIM

11. Në lidhje me zgjatjen e kërkuar të afatit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh numrin dhe gjatësinë e dokumenteve konkrete që kërkohen në Kërkesën e Thaçit për Materiale të Rregullës 102(3),¹⁰ si dhe afatet e tjera të njëkohshme të ZPS-së në lidhje me materialet e rregullës 102(3).¹¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej vlerëson se zgjatja e kërkuar e afatit do të mundësojë diskutime *inter partes* që mund të kufizojnë apo shmangin kontestimet juridike të panevojshme lidhur me rëndësinë materiale të disa materialeve të rregullës 102(3).¹² Ndonëse njoftimi për pamundësinë e ZPS-së për t'iu përmbajtur afatit të përcaktuar mund të ishte parashtruar më herët, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se një vonesë e tillë u shkaktua nga përpjekjet vullnetmira për të përmbushur afatin e përcaktuar.¹³ Për më tepër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se është e rëndësishme që nxjerrja e materialeve dhe parashtrimi i kërkesave për masa mbrojtëse në lidhje me to të bëhen

¹⁰ Kërkesa, para. 2.

¹¹ Kërkesa, poshtëshënimi 3.

¹² Kërkesa, para. 2.

¹³ Kërkesa, para. 4.

në mënyrë të kujdesshme, për të shmangur problemet që mund të dalin nga nxitimi për t'iu përmbajtur afatit.¹⁴

12. Së fundi, meqenëse nxjerrja e materialeve të rregullës 102(3) ende vazhdon dhe zgjatja e kërkuar e afatit do të mundësojë diskutime *inter partes*, me çka mund të shmangen kontestimet e panevojshme mbi rëndësinë materiale të tyre, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se Mbrojtjes nuk i shkaktohet dëm me zgjatjen e afatit të ZPS-së për paraqitjen e kundërshtimeve mbi rëndësinë materiale të materialeve, dhe të afateve përkatëse për nxjerrjen e materialeve dhe/ose për masa mbrojtëse.

13. Në përputhje me sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë paraqitur arsye të vlefshme që përlligjin zgjatjen e kërkuar të afatit.

V. VENDIM

14. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **MIRATON** Kërkesën;
- b) **ZGJAT** afatin e ZPS-së për paraqitjen e kundërshtimeve mbi rëndësinë materiale të materialeve të kërkuara në Kërkesën e Thaçit për Materiale të Rregullës 102(3), deri **të premten, 1 tetor 2021**; dhe
- c) **ZGJAT** afatin e ZPS-së për nxjerrjen e materialeve dhe/ose parashtrimin e kërkesave për masa mbrojtëse në lidhje me materialin e kërkuar në Kërkesën e Thaçit për Materiale të Rregullës 102(3), deri **të martën, 12 tetor 2021**.

/nënshkrimi/

¹⁴ Kërkesa, para. 3.

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E premte, 24 shtator 2021
Në Hagë, Holandë